

Nr. 20/4 Prot
25.04.2017



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin Elbasan

VENDIM

Nr. 15 datë 25/04/2017

Për miratimin e lejes “ Për rehabilitimin e shtratit të lumit Shkumbin” , zona ura e Peqinit – Karinë – Rrogozhinë , Bashkia Peqin, Qarku Elbasan, subjektit “Benordo” shpk.

Në zbatim të ligjit 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 5 pika 2, neni 12 pika 2, neni 50 pika 2, neni 65. Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 416 datë, 13.05.2015, “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posacme, dokumentave shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore”, Në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, me Nr. 309, datë 31.05.2016, për “Ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Identifikimin e Nevojave për Rehabilitimin e Shtretërve të Lumenjve”, bazuar në shkresën Nr.9706 Prot, date 16.12.2016 të Ministrit të Bujqësisë ku dërgohet lista e segmenteve të miratuara për rehabilitimin e shtratit të lumit Shkumbin, Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit Nr. 5 datë, 16.02.2016, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor si dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit Nr 6. datë 16.02.2016, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor”, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin

VENDOSI:

Për miratimin e lejes “ Për rehabilitimin e shtratit të lumit Shkumbin” , zona ura e Peqinit – Karinë – Rrogozhinë , Bashkia Peqin, Qarku Elbasan, subjektit “Benordo” shpk.

Specifikimet e zones për rehabilitim :

Koordinatat:

X 4399331	Y 4545301
X 4399452	Y 4545102
X 4393820	Y 4546091

X 4393751	Y 4546593
X 4342005	Y 4547382
X 4391999	Y 4547147

Sip. e shfrytëzimit 0.558 Km²

Investimi i planifikuar për mbjelljen e pemëve në nr. pemësh 5000 pemë, lloji akacie

Gërmim, transport zhavorri me skreper në bregun e majtë në shtratin e lumit me vëllim 15000 m³

Prurjet sipas studimit

Prurja mesatare vjetore	Q _{mes.}	60m ³ /sek
Prurja mesatare e muajit më të thatë	Q _{min.}	25 m ³ /sek

Periudha e rehabilitimit në shtratin e lumit-gjatë gjithë vitit për një periudhë 5 vjecare.

Vendimi hyn në fuqi pas zbardhjes së tyre formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Agjencia e Basenit Ujor Shkumbin Elbasan

PËRGJEGJËS ABU

SHKUMBIN



KRYETARI I KBU SHKUMBIN

PREFEKTI I QARKUT

ELBASAN

Arben KAMAMI

